

OFERTA REFERENCE PER SHITJEN ME SHUMICE TE SEGMENTEVE
TERMINUESE (LINJA ME QERA)

nga

ALBtelecom Sh.a.

MAJ 2014

Hyrje

Albtelecom sh.a. është operator i Autorizuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike (AKEP) për ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë.

Oferta Reference e linjave me qira është paraqitur me poshtë në formën e një marrëveshjeje shërbimi që i ofrohet përdoruesve në përputhje me kuadrin rregullator në Republikën e Shqipërisë dhe në përputhje me termat dhe specifikimet teknike të kësaj oferte reference.

Në çdo rast Albtelecom sh.a. nuk do të jetë përgjegjës mbi dhe për përmbajtjen e transmetimit që realizohet nëpërmjet linjave me qira.

Kjo oferte reference ka vlefshmeri që nga data e publikimit të saj / e miratimit nga AKEP, dhe do të jetë në fuqi deri në publikimin e amendamenteve të saj apo një oferte të re reference nga Albtelecom sh.a.

Albtelecom ka të drejtë që të ndryshojë në çdo moment këtë oferte reference në përputhje me kuadrin rregullator në Republikën e Shqipërisë. Çdo modifikim i kësaj oferte do të publikohet në faqen web zyrtare të Albtelecom sh.a.

Për çdo modifikim të kësaj oferte reference për shkak të ndryshimit të tarifave si pasojë e Vendimeve të AKEP, Albtelecom sh.a. do të publikojë këto ndryshime në faqen web zyrtare dhe do të njoftojë përdoruesit në një afat jo më pak se 15 ditë për nënshkrimin e amendamenteve të kontratave respektive në përputhje me ofertën e re.

PERMBAJTJA

Pjesa e pergjithshme:

1. Hyrje
2. Objekti i Marreveshjes
3. Perkufizime dhe Interpretimi
4. Hyrja ne Fuqi dhe Kohezgjatja
5. Tarifat
6. Faturimi dhe Pagesat
7. Sanksione
8. Garancia bankare
9. Instalimi, Operimi e Mirembajtja
10. Mbrojtja dhe Siguria e rrjetit
11. Forcat madhore
12. Njoftimet
13. Teresia e Marreveshjes
14. Zgjidhja e mosmarreveshjeve dhe ligji i aplikueshem
15. Dispozita e fundit
16. Hartimi i marreveshjes
17. Nenshkrimi

ANEKSET

- Aneks 1- Perkufizime
- Aneks 2- Tarifat e sherbimit
- Aneks 3- Specifikimet teknike te Linjave me Qira
- Aneks 4- Marreveshja e Nivelit te Sherbimit (SLA)
- Aneks 5- Linjat me Qera
- Aneks 6- Formulari i Garancise Bankare
- Aneks 7- Formati i Proces-verbalit
- Aneks 8- Dokumentat

Kjo marreveshje per linja me qera ketu e me poshte do te referohet si **("MARREVESHJA")**, lidhet sot ne Tirane, nga dhe midis:

ALBTELECOM SH.A., person Juridik Shqiptar, i regjistruar me Vendim Nr.20820 date 16.02.1999 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor, Tirane, me Nr.Nipti J61824053N, perfaqesuar nga **Z. Erkan TABAK** ne cilesine e Drejtorit te Pergjithshem, me adrese zyrtare ne rrugen "Myslym Shyri" Nr 42, Tirane, qe me poshte do te quhet **"OPERATOR"**.

dhe

_____, person Juridik _____, me Nr.Nipti_____, (autorizuar nga AKEP me Autorizimin Nr. ____ date ____ per ofrimin e linjave me qira) perfaqesuar nga **Z. _____** ne cilesine e _____, me adrese zyrtare ne _____, qe me poshte do te quhet **"PERDORUES"**.

Ketu e me poshte referuar si PALET dhe individualisht si Pala

1. Hyrje :

- 1.1 Albtelecom sh.a. eshte operator i Autorizuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike (AKEP) per ofrimin sherbimeve dhe rrjeteve te komunikimeve elektronike ne Republiken e Shqiperise.
- 1.2 Kjo marreveshje lidhet dhe nenshkruhet ne perputhje me Vendimin nr. 2415 date 04.02.2014 te AKEP.
- 1.3 Palet hyjne ne kete marreveshje per ofrimin e sherbimeve respektive te komunikimeve elektronike me cilesi dhe ne perputhje me kushtet e pergjithshme dhe specifike te kesaj Marreveshje.
- 1.4 Palet ne çdo rast marrin persiper te veprojne ne menyre korrekte, duke u bazuar ne parimet e tregtise se ndershme per zbatimin sa me eficient te kesaj Marreveshje dhe ofrimin e sherbimeve me cilesi te larte.

2. Objekti i Marreveshjes

- 2.1 OPERATORI ofron Linja me Qira, me qellim lidhjen e dy ose me shume nyjeve te Perdoruesit te percaktuara ne Aneksin 5, i cili merr ne perdorim keto linja, kundrejt tarifave te sherbimit (Aneksi 2), specifikimeve teknike (Aneksi 3), afateve dhe kushteve te percaktuara ne kete Marreveshje.

3. Perkufizime dhe Interpretimi:

- 3.1 Per Interpretimin e kesaj Marreveshje, Anekseve bashkengjitur apo korrespondences ne lidhje me zbatimin e Kontrates apo shtesave, ndryshimeve te mundshme te saj, jane perdorur terma kuptimi i te cilave percaktohet ne Aneks 1 "Perkufizime".

4. Hyrja ne Fuqi dhe Kohezgjatja

- 4.1 Kontrata hyn ne fuqi me nenshkrimin e saj nga palet, dhe eshte e vlefshme per nje periudhe jo me pak se nje (1) vjecare. Faturimi per ofrimin e sherbimit sipas kesaj kontrate do te fiilloje nga data e nenshkrimit te procesverbalit te testimi te mirefunksionimit dhe pranimit te linjave.
- 4.2 Palet bien dakort qe 30 dite perpara perfundimit te afatit te vlefshmerise se kesaj marreveshje, te negociojne mbi termat dhe kushtet e marreveshjes. Ne rast te kundert, marreveshje do te rinovohet automatikisht per te njejten periudhe dhe me te njejtat kushte.
- 4.3 Kjo marreveshje mund te perfundoje perpara afatit nese:
- a) Palet jane te detyruar te nderpresin zbatimin e kesaj marreveshje si pasoje e ndonje urdhri me fuqi detyruese per palet te organeve kompetente ne Republikën e Shqiperise
 - b) Palet nderpresin/ zgjidhin kontraten ne perputhje me percaktimet e kontrates.

5. Tarifat

- 5.1 Tarifat per dhenien me qira te linjave objekt marreveshje jane te percaktuara ne Aneksin nr. 2 te Kontrates (Tarifat e Sherbimit) dhe do te jene ne fuqi deri ne perfundimin e afatit te vlefshmerise se Kontrates me perjashtim te rasteve kur ato ndryshohen nga AKEP me ndonje akt rregullator.

- 5.2 Operatori ka te drejte te ndryshoje keto tarifa vetem ne perputhje me percaktimet e Ligjit Nr.9918 date 19.05. 2008 "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise".
- 5.3 Ne cdo rast ndryshimi te tarifave te aplikuara, Operatori do te njoftoje Perdoruesin 15 dite perpara per tarifat e reja dhe daten e hyrjes se tyre ne fuqi.
- 5.4 Njoftimi do te jete i publikuar ne faqen zyrtare te operatorit, si dhe do T'i dergohet me shkrim Perdoruesit.

6. Faturimi dhe Pagesat

- 6.1 Operatori, brenda dates 5 te cdo muaji pasardhes, do te faturroje sherbimin objekt marreveshje ne perputhje me Tarifat e percaktuara ne Aneksin 2 te Kontrates, dhe Perdoruesi do te paguaje sipas fatures tregtare te leshuar nga Operatori.
- 6.2 Perdoruesi do te realizoje pagesen e fatures se emetuar nga Operatori brenda 15 ditesh nga data e emetimit te saj.
- 6.3 Pagesa do te kryhet ne llogarine bankare te Operatorit: Banka ____Nr_____. Si Date pagese do te konsiderohet data kur ne llogarine bankare te Operatorit eshte bere kalimi i plote i vleres se faturuar nga Operatori.
- 6.4 Palet bien dakort qe Te gjitha taksat dhe detyrimet ligjore do te paguhen nga pala pergjegjese sipas ligjeve dhe rregullave ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.
- 6.5 Perdoruesi do te paguaje komisionet perkatese bankare.

7. Sanksione

- 7.1 Ne rast vonese ne pagese nga ana e Perdoruesit, per cdo dite vonese do te aplikohet nje penalitet ne masen 0.5 % te fatures mujore por jo me shume se 10 dite kalendarike.
- 7.2 Operatori ka te drejte te pezulloje ofrimin e sherbimit ne rast se Perdoruesi nuk permbush detyrimet e tij sipas percaktimeve ne kete marreveshje, duke e njoftuar me shkrim Perdoruesin, dhe duke i lene atij nje afat kohor prej 3 ditesh per rregullimin e shkeljes apo mospermbushjes se detyrimit ne fjale.

- 7.3 Operatori ka te drejte te perfundoje kontraten ne menyre te njeanshme ne rast se Perdoruesi nuk permbush ne menyre te perseritur detyrimet e tij financiare per nje periudhe prej 10 ditesh kalendarike.

8. Garancia Bankare

- 8.1 Perdoruesi i siguron dhe i dorezon Garancine Bankare Operatorit sipas formatit te garancise percaktuar ne Aneksin 6 te kesaj Marreveshjeje. Per kete qellim, Perdoruesi duhet te ngurtesoje ne favor te Operatorit, ne nje nga Bankat e Nivelit te dyte te cilat operojne ne Republiken e Shqiperise, nje shume ne masen sa vlera e detyrimit kater (4) mujor qe Perdoruesi i detyrohet Operatorit ne perputhje me termat e kesaj kontrate.
- 8.2 Garancia Bankare duhet t'i dorezohet Operatorit brenda 3 diteve nga nenshkrimi i marreveshjes , dhe eshte kusht per vlefshmerine e marreveshjes, ofrimin e sherbimit dhe fillimin e testimit te sherbimit. Garancia do te jete e vlefshme per nje periudhe gjashtembedhjete (16) mujore nga data e leshimit te saj nga Banka. Ne rast rinovimi te marreveshjes, Perdoruesi duhet te rinovoje edhe Garancine Bankare ne perputhje me percaktimet e rena dakort ne marreveshje. Nje muaj perpara dates se perfundimit te periudhes se vlefshmerise se garancise, do te dorezohet nje Garanci Financiare e re. Ne momentin e dorezimit te Garancise Financiare te re, pala perfituese e Garancise Financiare do t'i ktheje pales tjetere Garancine Financiare pararendese. Deshtimi per te rinovuar apo dhene nje garanci te re, i jep pales tjetere te drejten te nderprese sherbimin.
- 8.3 Kjo shume do te garantoje Operatorin per likuidimin detyrimeve financiare kontraktuale te Perdoruesit ndaj Operatorit qe rrjedhin nga Marreveshja.
- 8.4 Operatori ka te drejte te preke garancine bankare te ngurtesuar nga Perdoruesi, ne rast se ky i fundit nuk paguan detyrimet financiare per me shume se 10 dite kalendarike, duke e njoftuar Perdoruesin me shkrim, 3 dite perpara prekjes se garancise.
- 8.5 Ne rast prekjeje te garancise Bankare, Perdoruesi duhet te zevendesoje shumen e prekur te garancise brenda 5 diteve nga data e prekjes se saj.
- 8.6 Ne cdo rast, rimbushja e garancise duhet te kryhet per sasine e plote te vleres se prekur te saj, ne rast te kundert, Operatori ka te drejte te pezulloje marreveshjen me Perdoruesin deri ne nje moment te dyte kur Perdoruesi do te permbush te gjithet detyrimet qe rrjedhin nga kjo marreveshje.

- 8.7 Ne rast se Perdoruesi nuk rimbush garancine brenda 10 diteve kalendarike nga pezullimi i ofrimit te sherbimit si rezultat i parashikimeve te pikes 8.4 te ketij neni, Operatori ka te drejte te perfundoje kontraten ne menyre te njeanshme pa detyrim informimi kundrejt Perdoruesit.
- 8.8 Ne rastin e zgjidhjes apo perfundimit te Marreveshjes mes paleve, perpara afatit 16 mujor te garancise, Garancia bankare do t'i kthehet pales e cila ka bllokuar shumen e caktuar, pasi kjo e fundit te kete bere nje kerkese me shkrim per zhbllokimin e kesaj Garancie bankare, por ne cdo rast garancia bankare do te zhbllokohet vetem pasi pala qe ka bllokuar shumen, te kete shlyer cdo detyrim sipas Marreveshjes, subjekt i se ciles eshte kjo Garanci bankare, duke perfshire edhe detyrimet qe rrjedhin nga procesi i instalimit dhe investimit te Operatorit per ofrimin e sherbimit.
- 8.9 Palet bien dakort se vlera e garancise bankare do te ndryshoje ne perpjestim me objektin e marreveshjes. Ne cdo rast, garancia e re duhet te jepet brenda 3 diteve nga nenshkrimi i ndryshimit perkates, dhe deshtimi per te dhene garancine e re, i jep Operatorit te drejten te nderprese ofrimin e sherbimit deri ne dorezimin e garancise dhe marrjen e masave te percaktuara ne piken 8.7 te ketij neni.

9. Instalimi, Operimi dhe Mirembajtja

- 9.1 Pas plotesimit te gjithë dokumentacionit perkates dhe pergjigjes zyrtare te Operatorit ne lidhje me mundesine e ofrimit te sherbimit, ky i fundit do te realizoje ofrimin e sherbimit ne favor te Perdoruesit, ne perputhje me percaktimet e Aneksit 3.
- 9.2 Palet bien dakort qe per ofrimin e sherbimit dhe mirefunksionimin e tij, pergjate nje periudhe 3 ditore pune te kryhen te gjitha testet e nevojshme per te cilat palet bien dakort.
- 9.3 Ne cdo rast, Palet do te hartojne nje procesverbal mirefunksionimi, i cili do te nenshkruhet nga perfaqesuesit respektive ose persona te autorizuar te te dy paleve.
- 9.4 Procesverbali i hartuar per mirefunksionimin e sherbimit do te jete ne perputhje me percaktimet e Aneksit 3.
- 9.5 Si date e ofrimit te sherbimit do te konsiderohet date e firmosjes se Proces – Verbalit te testimi per mirefunksionimin e sherbimit, i mbajtur midis paleve. Data

e hyrjes ne fuqi te kontrates do te jete sic percaktohet me siper, por ne cdo rast jo me vone se 15 dite nga data e nenshkrimet te kontrates nga palet.

- 9.6 Procedurat me te detajuara per Instalimin, Mirembajtjen dhe Operimin e Linjes me qira Objekt Marreveshje, jane te percaktuara ne Aneksin 3 "Specifikimet Teknike" dhe ne Aneksin 4 "Service level agreement" te marreveshjes.

10. Mbrojtja dhe siguria e rrjetit

- 10.1 Palet marrin persiper qe gjate veprimeve operacionale te tyre te mbrojne dhe te mbajne te sigurt integritetin fizik dhe funksional te linjave me qira.
- 10.2 Asnjera Pale nuk do te lidhe dhe nuk do te lejoje lidhjen me rrjetin e saj te çdo pajisje apo aparature, duke perfshire, por pa u kufizuar ne, çdo pajisje terminale qe nuk eshte miratuar per perdorim nga autoriteti perkates, apo qe mund te shkaktoje perkeqesim ose keq funksionim te rrjetit te pales tjeter.

11. Forcat Madhore

- 11.1 Forca madhore i çliron palet nga pergjegjesia per mos permbushje te pjesshme apo te plote te detyrimeve te tyre sipas kushteve te kesaj marreveshje. Forca madhore do te konsiderohen rastet e fatkeqesive natyrore si termetet, permbytjet, zjarret, shperthimet, si dhe epidemite masive, si dhe gjendja e luftes, gjendja e jashtezakonshme. Ne rastin e forces madhore, palet duhet te njoftojne njera-tjetren per ekzistencen e nje fakti te tille.

12. Njoftimet

- 12.1 Informacioni ndermjet paleve do te shkembetet ne menyre elektronike dhe vetem nepermjet personave te autorizuar. Çdo njoftim lidhur me kete marreveshje dhe anekset e saj, behet duke njoftuar menjehere palen tjeter me shkrese zyrtare ne pikat e meposhtme te kontaktit:

Per Operatorin:

Emri: _____

Telefon: _____

Fax: _____

Email: _____@albtelecom.al

Per Perdoruesin:

Emri: _____

Telefon: _____

Fax: _____

E-mail: _____

13. Teresia e Marreveshjes

Pjese integrale e kesaj marreveshje jane:

- Aneksi Nr.1 "Perkufizime".
- Aneksi Nr.2 "Tarifat e Sherbimit" per Linjat Kombetare,
- Aneksi Nr.3 "Specifikimet teknike te Linjave me Qira dhe Mundesia Teknike"
- Aneksi Nr.4 "Service Level Agreement" (S.L.A.)
- Aneksi Nr.5 "Linjat me qira"
- Aneksi Nr.6 "Formulari i garancise Bankare"
- Aneksi Nr.7 "Formati i procesverbalit"
- Aneksi Nr.8 "Dokumentat"

14. Zgjidhja e mosmarreveshjeve dhe ligji i aplikueshem.

Operatori dhe Perdoruesi duhet te bejne çdo perpjekje te zgjidhin mosmarreveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose ne lidhje me kete marreveshje me negociata direkte dhe mirekuptim. Nese palet deshtojne ne zgjidhjen e mosmarreveshjes ose konfliktit, problemet do te konsiderohen me ane te zgjidhjes se mosmarreveshjeve sipas kontrates dhe procedurave juridike ne fuqi sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise. Kur problemet qe dalin mes paleve nuk zgjidhen me mirekuptim, seciles pale i lind e drejta t'i drejtohet gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kjo Marreveshje do te rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise.

15. Dispozita e fundit

Kjo marreveshje do te jete e detyrueshme per palet e kesaj marreveshje si dhe per subjektet juridike pasardhese te tyre te cilet do te trashegojne te gjitha te drejtat dhe detyrimet e subjektit pasardhes te tyre. Kjo eshte e detyrueshme ne rast se gjate kohezgjatjes se kontrates, çdo njera nga palet do te zevendesohet nga nje person juridik tjetër.

16. Hartimi i marreveshjes

Marreveshja hartohet ne 2 (dy) kopje te njevlreshme, ne Gjuhen Shqipe, nga nje per secilen pale.

17. Nenshkrimi

Kjo Marreveshje pasi u lexua nga Palet, nenshkruhet prej tyre ne Tirane, me date ____
_____.

Per OPERATORIN :

Per PERDORUESIN :

ALBTELECOM sh.a.

Emri dhe firma e Perfaqesuesit

Emri dhe firma e Perfaqesuesit

Erkan TABAK

.....

Drejtore i Pergjithshem

.....

ANEKSI 1

“Perkufizime”

Operator Operator i shërbimit të komunikimeve elektronike që ushtron aktivitetin në përputhje me Autorizimet përkatëse për ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike.

Perdorues Person Juridik apo Fizik i cili merr në përdorim linjë me qira sipas kushteve dhe tarifave të kësaj Marrëveshjeje.

Linjë me qira Linjë telekomunikacioneve e cila është në pronësi të Albtelecom sh.a. dhe mirëmbahet nga ky i fundit në përputhje me rregullat dhe standartet e kompanisë.

Linjë me qira me shumicë Linjë të njëjta si linjat e ofruara klienteve fundorë, me ndryshimin se blerësi është një kompani telekomunikacioni apo sipërmarrës i rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike (rregjistruar në AKEP);

Linjë me qira me pakicë përfshin të gjithë elementet e një apo me shumë rrjeteve për të siguruar kapacitete transmetuese ndërmjet dy pikave të ndryshme, pa përfshirë funksionet komutuese të kontrolluara prej përdoruesit të tyre. Ofruesi i linjës me qira me pakicë është operatori që ka lidhje direkte me blerësin e saj.

Terminime Lokale të Linjave me qira janë pjesë të linjave me qira që lidhin centralin lokal me ambientet apo ndërtuesat e klientit.

Trank Segmente ose Trank Seksione” janë pjesë të linjave me qira që ndodhen mes dy nyjave kryesore të rrjetit të ndërtuar: lidhja midis centraleve lokale dhe tranzite.

Kufiri ndares midis segmenteve terminuese dhe trank” është centrali që lidhet direkt me përdoruesin e linjës me qira.

Linjë të pjeshme (Leased Line Partial Circuits) linjë transmetimi që lidhin një klient fundor të operatorit tjetër me pikën e interkoneksionit të Operatorit me operatorin tjetër si dhe linjat e transmetimit të ofruar nga Operatori, përdoruesve të tjerë për tu përdorur në interkoneksionin e ndërmjetëm apo në anën e klientit.

ANEKSI 2
“Tarifat e Sherbimit”

Tarifat per Linjat Kombetare me Qira:

Sherbim	Tarifa fikse (ALL)		Tarifa variabel (ALL/km)	
	Pakice	Shumice	Pakice	Shumice
Pajtimi mujor				
2 mbps	16,482	13,735	1,068	890
34 mbps	300,000	250,000	9,000	7,500
155 mbps	600,000	500,000	18,000	15,000
Tarifa e Instalimit				
2 mbps segments Termination	5,886	4,905		
34 mbps	462,000	385,000		
155 mbps	516,000	430,000		

- Tarifat e mesiperme nuk perfshijne TVSH.

ANEKSI 3

"Specifikimet teknike te Linjave me Qira dhe Mundesia Teknike"

1.1 Specifikime te sherbimit

Linjat me qira i referohen nje linje dixhitale me shpejtesi transmetimi te specifikuar ne tabelat 1 dhe 2, vendosur midis 2 pikave brenda rrjetit te Operatori, nepermjet te cilave Perdoruesi i sherbimit, u ofron sherbime telekomunikacioni perdoruesve fundore ose operatoreve te tjere.

Tabela 1: Karakteristikat Teknike te linjave me qira, qe jane objekt i ofertes se Operatorit

Linjat dixhitale	
Shpejtesia transmetimit	Rekomandimet e ETSI
2048 kb/s-E1	ETSI EN 300 418 ETSI EN 300 419

Tabela 2: Nderfaqja e kerkuar e pajisjes terminuese

Linjat dixhitale	
Shpejtesia e transmetimit	Nderfaqe
2048 kb/s-E1	G.703
≤ 2048 kb/s-E1	G.704, V.35
155 Mb/s	G.707, G.958

1.1.1 Sherbimi i Linjave me qera mbi protokollin Ethernet

Sherbimi i linjave me qera mbi protokollin Ethernet i ofron klientit nje kanal transmetimi pike me pike duke perdorur teknologjine Ethernet. Sherbimi lokalizohet ne shtresen 2

referuar modelit te shtresave te protokollit. Sherbimi ne teknologjine Ethernet eshte transparent persa u perket niveleve me te larta te shtresave te protokollit. Linja private virtuale e Ethernetit gjeneruar per klientin eshte e mbyllur, keshtu qe trafiku brenda linjes me qera eshte e sigurt. Sherbimi i Linjave me qera te Albtelecom eshte i mundur me shpejtesi te ndryshme lidhjeje brenda vendit po ashtu edhe jashte vendit.

Permbajtja e sherbimit

Linja me qera Ethernet eshte e formuar nga dy pika fundore te cilat vendosen ne krahun e abonentit, dhe nga kanalet logjike (EVC Ethernet Virtual Circuit) ndermjet tyre. Lidhja nga MPLS deri tek abonenti do te realizohet me konvertera per ato raste kur kerkohet sherbimi E1 mbi Ethernet

Teknikisht sherbimi bazohet ne rrjetin e Albtelecom (IP/MPLS network)

Permbajtja e paketes baze te linjes me qera mbi Ethernet eshte si me poshte:

- Mundesi lidhjeje ndermjet dy abonenteve nepermjet rrjetit Albtelecom
- SLA Niveli i sherbimit baze

Sherbimet shtese

Sherbimet shtese per linjat me qera mbi Ethernet perfshijne

- Kualitetin e trafikut ne Ethernet (CoS, Class of Service)
- Sherbimet nderkombetare
- SLA Niveli i sherbimit special
- Sherbimi i lidhjes reserve (backup)

Tabela 3: Nderfaqja e kerkuar e pajisjes terminuese


Tipi i nderfaqes fizike	Tipi i nderfaqes	Shpejtesia maksimale	Specifikimet
E	10BaseT IEEE 802.3	10M	Konektore RJ-45 kategoria 5e, kabell UTP
FE	100BaseTX IEEE 802.3	100M	Konektore RJ-45 kategoria 5e, kabell UTP

GE	1000BaseT IEEE 802.3	1G	Konektore RJ-45 kategoria 5e, kabell UTP
	1000BaseLX IEEE 802.3		Konektore fibre single-mode

Linjat me qira te cilat jane objekt i "Oferte References per Linjat me Qira",

- Linjat me qira pike me pike
- Linja me qira te pjesshme

Linjat me qira pike me pike ofrojne nje lidhje te vazhdueshme midis dy pikave nepermjet rrjetit te Operatori, sic paraqitet ne Figuren 1.




1.2 Rrjeti i linjave me qira

Fig.1: Oferte referenca per linjat me qira me shumice

Linjat me qira te pjesshme ofrojne lidhje, nga pika fundore, nepermjet rrjetit Operatori, ne piken e lidhjes me rrjetin e operatorit qe eshte kufiri mes rrjetit te nje Operatori dhe operatorit tjetër.

Linjat e pjesshme me qira paraqiten ne Figuren 2

Fig.2



Oferta e linjave te pjesshme me qira konsiston ne 2 komponente:

- Linja e perdoruesit, e cila mundeson lidhjen e rrjetit dhe te pikes fundore te aksesit, brenda rrjetit te Operatorit, per lidhjen e linjes se operatorit. Lidhjet 2 filleshe realizohen ne formen e linjave $n \times 64 \text{ kb/s}$ dhe 2 Mb/s ;
- Linja e cila mundeson lidhjen e rrjetit te Operatorit dhe linjes se perdoruesve te vendosur midis pikes se aksesit dhe pikes se lidhjes midis dy rrjeteve. Linjat realizohen ne formen e $n \times 2 \text{ Mb/s}$, 34 Mb/s dhe STM-1 ne variante te ndryshme.

Ne pikat mbeshtetese perfshihen pikat ne te cilat ka nje zhvendosje te pergjegjesive dhe pronesise se pajisjes mes Perdoruesit dhe Operatori ne nje nivel fizik. Pika e kufirit perfshin energjine, tokezimin, nderfaqet e shenuara ne tabelen 2 dhe lidhja e fibrave optike.

Ne rastin kur Operatori vendos pjese te pajisjeve te transmetimit dhe DDF ne vendodhjen e Perdoruesit, Pika fundore e pergjegjesise se Operatorit eshte connectori ne kete DDF ne te cilin terminohet pajisja e transmetimit, nepermjet te cilave kalojne linjat me qira.

Sherbimi i linjave me qira me shumice, ofron brenda fasiliteve te telekomunikacionit te disponueshme ne rrjetin e aksesit, marrje me qira te rrjetit dhe kanale dixhitale te sistemeve te transmetimit, dhe ne kete kuptim nuk kerkohet modifikimi i atyre ekzistues dhe / ose ndertimi i te rejave.

Oferte referenca per linjat e telekomunikacionit me qira me shumice mundeson ofrimin e sherbimeve te linjave me qira me shumice me kerkese te Perdoruesit.

1.3 Kerkesat teknike per implementimin e sherbimit

Operatori merr persiper ofrimin e sherbimit te linjave me qira sipas kerkeses se Perdoruesit dhe ne perputhje me kushtet dhe afatet e kesaj marreveshje, vetem ne rastin e mundesise dhe plotesimit te kushteve teknike te duhura per ofrimin e ketij sherbimi.

Operatori merr persiper ofrimin e sherbimit te linjave me qira sipas kerkeses se Perdoruesit dhe ne perputhje me kushtet dhe afatet e kesaj marreveshje, vetem ne perputhje dhe brenda kuadrit te autorizimit te Operatorit ne lidhje me sherbimin ne fjale.

Asnje kerkese e pales nuk do te jete detyruese per Operatorin nese eshte jashte objektit te autorizimit te Operatorit ose jashte mundesive dhe kapaciteteve teknike te Operatorit dhe perdoruesi nuk do te kete asnje pretendim mbi kete.

Kushtet teknike per lidhjen e linjave me qira te telekomunikacionit, ne kuader te ofertes perfshijne:

- Ekzistencen e kapacitetit te mjaftueshem ne rrjetin e aksesit, dhe ne rrjetin e transmetimit te Operatorit, ne varesi te llojit dhe linjes se qarkut me qira te telekomunikacionit.
- Permbushja e kushteve te pershtatshme te Perdoruesit per lidhjen, funksionimin dhe mirembajtjen e linjave me qira te telekomunikacionit. (pajisje fundore e standartizuar dhe e pershtatshme, instalimet elektrike te pershtatshme etj) te percaktuara ne paragrafin 4.3

1.4 Procesi i testimit te pajisjes dhe sherbimet e lidhjes.

a) Procesi i testimit te pajisjes

Per te percaktuar se pajisja e perdoruesit pershtatet me pajisjet e Operatorit, dhe krijimin e mundesise se lidhjes se pajisjes se perdoruesit me Operatorin; sipas kerkeses se Operatorit mund te realizohen teste shtese te pershtatshmerise dhe mirefunksionimit midis pajisjeve qe do te lidhen.

Operatori do t'i kerkoje perdoruesit certifikaten e perputhshmerise me standartet nderkombetare (ITU-T, ETSI) te emetuara nga shitesi i pajisjes per implementimin e sherbimeve. Palet bien dakort mbi testet e nevojshme dhe masat e tyre. Testet do te kryhen ne perputhje me rekomandimet perkatese te ITU-T dhe standartet ETSI

Nese ne te njejten kohe, Operatori merr nje kerkese per te testuar dy ose me shume sherbime/kerkesa te perdoruesit, Operatori do te caktojte nje liste prioritetesh ku do te renditen aplikimet dhe do te njoftohet Perdoruesi per kohen e fillimit te testimit.

Testet qe vijojne do te kryhen sa here qe vendoset nje marredhenie sherbimi e re.

b) Testimi i nderfaqes G.703 E1

- Matjet e frekuences
 - Matjet e frekuences 2048 MHz E1 \pm 50 ppm
 - Tolerance e zhvendosjes se frekuences \pm 50 ppm
 - Forma e impulsit elektrik te nderfaqes.

Forma e pulseve ne dalje duhet te jete ne perputhje me ITU-T G.703 mask

c) Testimi i nderfaqes optike 155 Mb / s

- Matjet e fuqise se transmetimit si dhe ndjeshmeria marrese
- Forma e pulseve ne dalje duhet te jete ne perputhje me ITU-T G.957.

d) Matja e cilesise se transmetimit

Cilesia e transmetimit testohet vecmas per cdo drejtim transmetimi, dhe nese cilesia e transmetimit testohet ne linja te mbyllur (loop), atehere kerkesa per cilesi transmetimi mbetet e pandryshuar ashtu sic eshte testuar ne vecanti per cdo drejtim transmetimi.

Kontrolli i cilesise do te behet duke matur ES (error bits per second) dhe SES (significant error bits). Per te percaktuar kufijte e pranueshmerise se cilesise se transmetimit aplikohen drejtperdrejte Rekomandimet e ITU-T, M.2100 and M.2101.

Procedura e testimit te cilesise se transmetimit kryhet ne perputhje me Rekomandimet e ITU-T, M.2100 and M.2101.

Cilesia e kerkuar nuk varet ne gjatesine dhe llojin e sistemit te transmetimit.

e) Matjet e rrjetit te aksesit ne çift

Parametrat qe do maten ne nje rrjet aksesi per realizimin e shitjes me shumice nga Operatori per linjat e dhena me qira per sherbimet e linjes jane:

- rezistenca dhe izolimi mes çifteve te linjes;
- rezistenca dhe izolimi ndermjet dy linjave dhe linjave tokesore;
- shuarja ndermjet dy linjave te sektorit te njejte;
- rezistence maksimale loop;
- shuarja maksimale e linjes per BER xDSL per te garantuar <10⁻⁷;
- shuarja maksimal per linjen NTU (Pika fundore e rrjetit).

Pasi Operatori ka perfunduar konfigurimin e pajisjeve dhe proven e testit te lidhjes ne nivel lokal per te verifikuar saktesine e pajisjes, nese eshte e nevojshme, mund te behen nje matje shtese te linjes ne te cilen do te lejohen transferimi i te dhenave.

f) Matjet ne pajisjet e rrjetit per dhenien me qira te kanaleve dixhitale NX 64 kb / s

Pajisja fundore qe do te lidhet ne rrjet per dhenien me qira te kanaleve dixhitale , do te testohet paraprakisht nga Operatori.

1.5 Lidhja e sherbimeve

Linja e dhene me qira nga Operatori do te lidhet ne vendin e specifikuar ne Proces-verbalin e testimi dhe te pranimit, ne perputhje me termat dhe kushtet e percaktuara ne oferten e references. Per kete qellim, Operatori ne te dy skajet e linjes se dhene me qira do te montoje pajisjen lidhese te linjes se telekomunikacionit qe lidh pajisjet fundore te zoteruara nga Perdoruesi. Perpara dhenies se linjave me qira, eshte e nevojshme te perfundohen me sukses testet e linjave te dhena me qira pergjate rruges se transmetimit ne rrjetin e Operatorit, dhe testimi pike me pike ne kohezgjatje minimale prej 24 ore ditesh, te kryera nga Perdoruesi.

Testimi pike me pike mund te kryhet vetem pas aprovimit te testeve te kryera.

Secila pale eshte e detyruar te konfirmoje me shkrim kryerjen e testit ne menyre te sukseshme.

Rrugesimi brenda rrjetit te linjave me qira, realizohet nga Operatori sipas rregullave te cilat aplikohen nga Operatori.

Perdoruesi ne vendin e lidhjes, me shpenzimet e tij do te siguroje hapesine per lidhjen dhe instalimin e pajisjeve ndihmese te telekomunikacionit, pajiset e duhura fundore, koston e energjise se nevojshme per funksionimin e saj, instalimin dhe mirembajtjen, sipas nevojës, duke perfshire edhe instalimin ne terren sipas rregullave ne fuqi.

Perdoruesi eshte plotesisht pergjegjes per perdorimin e hapeses per lidhjen dhe instalimin e objekteve te telekomunikacionit, qe jane ne pronesi te Albtelekomit.

Perdoruesi duhet me shpenzimet e tij te mundesoje lidhjen me ambientet ne ndertesat e Operatorit per te kryer punimet, instalimin, testimin dhe mirembajtjen e linjave te marra me qira duke respektuar kerkesat e Operatorit per instalime te ketij lloji. Para lidhjes se linjave te dhena me qira, punonjesi i autorizuar i Operatorit do te testoje pajisjet fundore per te percaktuar nese ai ploteson kushtet e percaktuara ne kete oferte reference.

Per pajisjen fundore qe do te instalohet nga Operatori per qelimin e kryerjes se sherbimit te telekomunikacionit per dhenien e linjave me qira, Perdoruesi duhet te siguroje kushte adekuate per pune. Temperaturat e operimit duhet te jete ne rangun e 10-30 ° C ,ne nje lageshti relative prej 10% dhe te variojne nga -5° C ne 30 ,ne nje lageshti relative prej 95% (sipas Rekomandimit ETSI ETS 300019-1/2 ETSI / 3 klasa 3.2).

1.6 Ndryshimi i parametrave teknike

Operatori rezervon te drejten te beje ndryshime ne parametrat teknik te sherbimeve te linjave te dhena me qira, te shkaktuara nga zhvillimi teknik, apo rikonfigurimi i rrjetit te Operatorit per zgjerimin e tij, standarteve dhe rekomandime nderkombetare.

Operatori do te njoftoje perdoruesit per ndryshime ne rrjetin e Operatorit qe mund te ndikojne ne funksionimin e sherbimeve te linjave te dhena me qira me kontrate per perdorimin e linjave me qira, te pakten nje (1) muaj para zbatimit te ketyre ndryshimeve. Kjo dispozite nuk zbatohet ne rastin e nje marreveshjeje paraprake reciproke midis Operatori dhe perdoruesit.

Perdoruesi eshte rreptesisht i ndaluar per te ndryshuar parametrat e line interface te dhena me qira, pa pelqimin paraprak me shkrim te Operatorit.

Perdoruesi eshte pergjegjes per te gjitha shpenzimet qe dalin nga zbatimi i ndryshimeve ne kete seksion.

1.7 Ofrimi i sherbimit

Operatori në ofrimin e linjave me qira me shumicë merr persiper të zbatojë afate kohore maksimale të plotësimit të kërkesave për linja me qira, sipas afateve të dhena më poshtë duke filluar nga dita e dhenies se nje pergjigje zyrtare per mundesine e ofrimit te sherbimit:

1. per linjat me qira te pastrukturuara (unstructured) 2 Mbit/s: 45 dite kalendarike,
2. per linjat me qira te strukturuara (structured) 2 Mbit/s: 50 dite kalendarik,
3. per linjat me qira te pastrukturuara (unstructured) 34 Mbit/s: 60 dite kalendarike.
4. Per linjat me qira prej 155 Mbit/s: 60 dite kalendarike

ANEKSI 4

"Service Level Agreement" (S.L.A.)

1. Ky dokument përcakton nivelet e shërbimit, qe Operatori ofron në lidhje me dhenien dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të linjave me qira per perdoruesit e me te cilet ka lidhur Marreveshjen perkatese te Ofrimit te Linjave me Qira. SLA vlen dhe ofrohet vetem per mirembajtjen dhe funksionimin per rrjetin Albtelecom dhe brenda territorit te Republikes se Shqiperise. Albtelecom nuk do te mbaje asnje pergjegjesi dhe nuk ka asnje detyrim per probleme apo defekte qe mund te lindin nga marredhenie me palet e treta

2. Këto shërbime përfshijnë linjat me qira te linjës te kerkuar nga operatorë të tjerë të licencuar për qëllim të ofrimit te aksesit nga ambjentet e klientit me rrjetet e tyre. Shërbimet e tilla duhet të mbahen për një minimum prej 12 muajsh nga data e dorëzimit. Linjat e kerkuara për qëllime interkonjeksioni me rrjetin e transmetimit te Operatori nuk janë objekt i kushteve te kësaj SLA-je.

3. Në kete dokument eshte percaktuar edhe nje regjim penaliteti per rastet e mosplotesimit te niveleve te ofruara te shërbimit.

4. Perkufizimi i proceseve te shitjes
 - Dorezimi i Kerkeses (DK): Dorezimi i nje kerkese të vlefshme për Operatorin në një formular kerkese standard.
 - Pergjigja e kerkeses (PK): pergjigje nese kerkesa eshte e mundshme per tu realizuar nga Operatori brenda kuadrit te autorizimit te operatorit, kapaciteteve teknike dhe standardeve të përcaktuara në SLA. Koha e ofrimit te kerkesave standarde është në përputhje me kohen e percaktuar në Tabelën 1. Datat respektive do të jepen në Pergjigjen e kerkeses. Ne rastet kur është e nevojshme ketij hapi do ti paraprije një studim te realizimit teknik (site survey).
 - Konfirmimi i dorëzimit (KD): Operatori do të njoftoje me shkrim Perdoruesin nëse afati i dorëzimit do të plotesohet. Në rast Operatori konstaton se afati i dorezimit nuk permbushet do te njoftoje Perdoruesin per daten e re te dorezimit te sherbimit. Konfirmimi i dorezimit do te konsiderohet nje proces i vetem per llogaritjen e penalitetit.

- Dorezimi i Sherbimit (DSh): dorezimi i sherbimit te kerkuar nga Operatori per perdoruesin.
- Njoftimi i Dorezimit (ND): data e njoftimit te perfundimit te realizimit te kerkeses nga Operatori per Perdoruesin.
- Perfundimi i Kerkeses (PK): Një kerkese konsiderohet të jetë përfunduar me dërgimin e njoftimit të dorëzimit. Perdoruesi ka 2 ditë pune kohe për të pranuar kerkesen si te përfunduar siç është përcaktuar. Nëse perdoruesi nuk informon Operatorin per perfundimin e kerkeses, ajo do të konsiderohet të jetë pranuar nga klienti ne fund te kesaj kohe.
- Aktivizimi i sherbimit (ASh): aktivizimi i sherbimit te kerkuar nga Operatori

5. Permbledhje e parametrave te ofrimit te sherbimit nga Operatori

Tabela 1

Sherbimi	Pranimi i Kerkeses	Konfirmimi i Kerkeses	Data e Dorezimit	Konfirmimi i Dorëzimit	Njoftimi i Dorezimit
2 Mbps	T	T+20	T+40	DD - 3	DD
34 Mbps	T	T+20	T+40	DD - 3	DD
155 Mbps	T	T+20	T+40	DD - 3	DD

Shenim:

- T = Kerkesa pranohet nga Operatori
- DD = Data e dorezimit te sherbimit

6. Perkufizimi i riparimeve

- Koha e Riparimit: Periudha mes kohes se njoftimit te pare te defektit tek Operatori ne perputhje me procedurat e Operatori per njoftimin e defekteve dhe riparimit te plote te tij.
- Defekte te linjave me qira: Defekt eshte pamundesia per te transferuar te dhena pergjate linjes me qira.
- Disponueshmeria e sherbimit: Eshte koha vjetore e sherbimit te nje linje e shprehur ne perqindje. Llogaritet ne kete menyre: $[\text{Numri total i oreve ne Vit}] - [\text{Numri total i oreve jashte sherbimit}] / [\text{Numri total i oreve ne Vit}]$.
- Koha e pergjigjes:

- i. Defekti eshte njoftuar dhe shenuar ne menyre korrekte.
- ii. Jane kryer testet paraprake dhe lokalizimi i defektit.
- iii. Eshte njoftuar klienti per rezultatet e testimit paraprak dhe lokalizimin e defektit.
- iv. Ka filluar puna per riparimin e defektit.

7. Permbledhje e nivelit te sherbimit per parametrat e riparimit

Linja me qira (2Mbps dhe me shume se 2 Mbps)

Tabela 2

Parametri	
Koha maksimale e pergjigjes	T+5 ore pune T = koha ne te cilen defekti eshte njoftuar dhe shenuar ne menyre korrekte.
Disponueshmeria vjetore e sherbimit	90%

Penaliteti i disponueshmerise se sherbimit per linjat me qira

Tabela 3

Sherbimi	Penaliteti
2 Mbps	Do te aplikohet nje penalitet prej 20% te fatures mujore ne rast te mosrespektimit te nivelit minimal te sherbimit ne nje periodhe tre mujore.
34 Mbps	Do te aplikohet nje penalitet prej 20% te fatures mujore ne rast te mosrespektimit te nivelit minimal te sherbimit ne nje periodhe tre mujore.
155Mbps	Do te aplikohet nje penalitet prej 20% te fatures mujore ne rast te mosrespektimit te nivelit minimal te sherbimit ne nje periodhe tre mujore.

8. Kriteret e matjes se performances se SLA

Pergjigjja ndaj defekteve

- Koha e pergjigjes llogaritet qe ne momentin kur defekti eshte njoftuar dhe shenuar ne menyre korrekte dhe jane bere testimet paraprake dhe lokalizimi defektit, ka filluar procesi i riparimit te defektit dhe eshte bere njoftimi I perdoruesit per rezultatet e testeve paraprake dhe lokalizimin e defektit.
- Koha maksimale e pergjigjes eshte T + 5 ore pune, ku T eshte koha kur defekti eshte shenuar nga Operatori.

Matja e disponueshmerise se sherbimit

- Disponueshmeria e sherbimit do te matet (7 x 24) duke perdorur formulen:

$$\frac{[\text{Numri total i oreve ne Vit}] - [\text{Numri total i oreve jashte sherbimit}]}{[\text{Numri total i oreve ne Vit}]}$$

ANEKSI 5

Linjat me Qera

Ky aneks specifikon sherbimet qe merr operatori nga Albtelecom dhe do te plotesohet rast pas rasti me nenshkrimin e kontrates perkatese me cdo operator.

ANEKSI 6
FORMULARI I GARANCISË BANKARE

GARANCI PAGESE

PËRFITUESI: ALBTELECOM sh.a, Rruga "Myslym Shyri", nr 42, Tiranë

SHUMA: _____ lekë (shuma në shifra dhe fjalë)

PËR LLOGARI TË APLIKANTIT: _____(emri dhe adresa)

QËLLIMI I MBULIMIT: Detyrimet Finaciare të Marrëveshjes së Linjave me Qira nr.....dt.....

Në zbatim të Marreveshjes Nr.....dt..... me objekt **Ofrimin e Shërbimeve Linjave me Qira** Ne, Banka_____ jemi në dijeni që për të garantuar **përbushjen e detyrimeve financiare**, nga ana e Aplikantit_____(emri) me korrektësi, Aplikanti është i detyruar të vëndosë një garanci financiare në një Bankë Shqiptare në favor të Operatorit.

Me kërkesë të _____(emri) Ne, _____ Banka sh.a (adresa), marrim përsipër në mënyrë të përvokueshme dhe të pakushtëzuar që si detyruesi kryesor dhe jo vetëm si palë garante, sapo Operatori sh.a të bëjë kërkesen e parë me shkrim, të paguajmë brenda 3 ditëve pune, cdo shumë të faturave (detyrimeve financiare) të papaguara nga aplikanti kundrejt Operatori deri në vlerën totale të garancisë _____lekë (shuma në shifra dhe fjalë), pa kërkuar shpjegime dhe pa pasur asnjë lloj te drejtë kundërshtimi nga ana jonë, duke përmendur në kërkesë mospërbushjen e kushteve të Marrëveshjes së Linjave me Qira.

Me këtë garanci sigurojmë përfituesin Albtelecom sh.a se nuk është nevoja t'i drejtoheni më parë apo ti kërkohet miratim paraprak te aplikantit për të realizuar pagesën sipas kërkesës suaj.

Shuma totale e kësaj garancie do të reduktohet në mënyrë automatike për cdo pagesë të kryer sipas kësaj garancie.

Kërkesa juaj me shkrim, për pagesë duhet të paraqitet në _____ Banka sh.a, në adresën e mëposhtme: _____ Banka sh.a
(adresa e Bankës lëshuese të garancisë bankare)

Kërkesa për pagesë e garancise do të konsiderohet si e kryer në momentin që ne kemi kërkesën tuaj me shkrim për pagesë tek adresa jonë e sipërpërmendur.

Deklarojmë gjithashtu, se asnjë shtesë apo ndryshim i kushteve të kontratës, për të cilën ju mund të bini dakort me kontraktuesin, nuk na cliron nga detyrimet e kësaj Garancie.

Kjo Garanci bankare do të jete e vlefshme për një periudhë gjashtembedhjete (16) mujore, duke filluar nga dita e nënshkrimit të Marreveshjes.

Kjo garanci lëshohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.

_____ Banka sh.a
(firmat e autorizuara të bankës)

ANEKSI 7

PROCES – VERBAL

(i testimi të ofrimit të shërbimit të lidhjes linja me qira dhe pranimit të tij)

Ky procesverbal testimi dhe pranimi, ("Procesverbali") mbahet sot në datën _____, midis paleve:

Operatori

Dhe

_____.

Palet bien dakord e konstatojnë si vijon:

Palet kanë lidhur kontratën nr. _____ date _____ "Per ofrimin e shërbimit linja me qira"; Me datën ____ . ____ . ____ nga Albtelecom sh.a në cilësinë e operatorit u realizua ofrimi i shërbimit të lidhjes linja me qira me kapacitet _____, sipas përcaktimeve të kontratës nr. _____ date _____ "per ofrimin e shërbimit linja me qira", të lidhur mes paleve, si dhe specifikimeve teknike.

Gjithashtu u kryen testimet e nevojshme sipas parametrave dhe specifikimeve teknike për ofrimin e shërbimit të lidhjes linja me qira, me qëllim mirëfunksionimin e këtij shërbimi, sipas kushteve të rena dakord mes paleve me kontratën _____.

Testimi i shërbimit, u realizua në datat __, __, __, për tre dite rresht, dhe palet bien dakord se testimi i lidhjes rezultoi i suksesshem.

Data ____ . ____ . ____ do të konsiderohet si dita e fillimit të shërbimit për ofrimin e lidhjes linja me qira, me kapacitet _____, sipas kushteve të kontratës nga Operatori për _____ përdoruesi.

Ky procesverbal i mbajtur mes paleve kontraktuese, do të shërbejë si provë për ofrimin e shërbimit nga Operatori kundrejt _____ dhe të pranimit të linjave me qira nga ky i fundit.

Per _____

Per Albtelecom Sh.a

ANEKSI 8
Dokumentat e Operatorit Perfitues